



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.340/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “DRENA” SH.P.K., me NUI: 811014381, përfaqësuar sipas autorizimit nga G.R. avokate, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga B.Z., për shkak të anulimit të vendimin Nr. 39/19 të datës 16.12.2019, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor më datë 16.04.2024, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse G.R., dhe të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur B.Z., me datë 18.04.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit “DRENA” SH.P.K me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me seli në Prishtinë, si e bazuar.
- II. **ANULOHET** Vendimi Nr. 39/19 të datës 16.12.2019 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, dhe çështja i kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.
- III. **OBLIGOHET** e paditura që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Me datë 16.01.2020, në Gjykatën Themelore të Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative “DRENA” SH.P.K, ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.nr. 157/2020, kundër të paditurit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit Nr. 39/19 të datës 16.12.20109, i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, me propozim që Gjykata të aprovoj në tërësi si të themeltë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit “Drena” SH.P.K, dhe të anuloj si të paligjshëm vendimin Nr.39/19 të datës 16.12.2019, i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr.340/22.
3. Gjykata më datë 16.04.2024, mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit Avokate G.R., sipas autorizimit të datës 15.04.2024, dhe të përfaqësuesit të palës së paditur B.Z., sipas autorizimit të datës 16.04.2024.

Pretendimet e paditës

4. Përfaqësuesit e paditësit në padi, në deklaratimet e dhëna me shkrim gjatë seancës gjyqësore, si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, më datë 01.05.2019 paditësja ka parashtruar kërkesën për mbështetje financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2019, për nën masën 103.1 përpunimi i qumështit, pran Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë tutje, AZHB, në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, tutje MBPZHR, ku bashkë me kërkesën janë parashtruar edhe dokumente të tjera të kërkuara nga AZHB. Më datë 14.10.2019, AZHB-ja ka marr vendim Ref. AZHB 07/04/03/4238/20109, sipas të cilit paditësit i refuzohet kërkesa për përkrahje të projekteve për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, me arsyetim se bazuar në opinionin ligjorë të departamentit ligjorë të MBPZHR-së, të datës 08.10.2019, lidhur me pronësinë e subjektit afarist “Drena” SH.P.K, përkatësisht N.N. R&Rukolli” SH.P.K., është

konstatuar se kanë të bëjnë me të njëjtin subjekt afarist edhe pronari juridik është i njëjti person. Në vijim, AZHB thekson se duke u bazua në dispozitat e UA nr. 16/2019, neni 13 par.5 nën par. 5.7, ndihma maksimale publike për periudhën e zbatimit të programit për bujqësi dhe zhvillim rural 2014-2020, për masën 103, është tetëqind mijë euro për përfitues. Rrjedhimisht AZHB konstaton se paditësja “Drena” SH.P.K., së bashku me N.N “R&Rukolli”, SH.P.K., si subjekt afarist i njëjtë kalojnë vlerën e përkrahjes publike prej tetëqind mijë euro .

5. Ka deklaruar se, ankesën e paditësit MBPZR-ja merr vendim Nr. 39/19 të datës 16.12.2019, me të cilin e refuzon si të pa bazuar ankesën e paditëses, nën arsyetimin e njëjtë të dhënë nga AZHB-ja. Ky vendim ka të meta procedurale ngase është i pa arsyetuar dhe i pa mbështetur në prova dhe në kundërshtim me nenin 48 par.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, tutje LPPA-së, duke dhënë një arsyetim të përgjithshëm dhe abstrakt meqenëse nuk ka konstatuar se ku e mbështet konstatimin e saj se “duke iu referuar subjektit afarist “Drena” SH.P.K., përkatësisht N.N. “R&Rukolli”, SH.P.K., konstatohet se kemi të bëjmë me të njëjtin subjekt afarist. Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, çdo ndërmarrje, respektivisht shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ka personalitet të ndarë juridik, prandaj një rast se një ndërmarrje është pronare apo aksionare e ndërmarrjes tjetër, nuk mund të thuhet se “kemi të bëjmë me të njëjtin subjekt afarist”, dhe se si subjekt afarist i njëjtë kalojnë vlerën e përkrahjes publike prej 800,000.00 euro, duke mos dhënë asnjë prove materiale që ti dëshmoj këto pretendime se N.N. R&Rukolli” SH.P.K., ka përfituar mbështetje financiare prej 800,000.00 euro në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për në masën 103 dhe gjatë periudhës 2014/2020.
6. Vendimi i kundërshtuar me padi është marrë duke shkelur dispozitat e ligjit material, respektivisht Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural respektivisht nenet 8 dhe 9 si dhe të UA Nr. 16/2019, për masat dhe kriteret e përkrahjes për Zhvillimin Rural për vitin 2019 i datës 21.05.2019 konkretisht nenet 13 par.5 nën par.5.7. Meqë vendimi është marrë duke e shkelur parimin e ligjshmërisë, i njëjti konsiderohet si Akt Administrativ i paligjshëm bazuar në nenin 4 par.2, dhe nenin 52 par 1.1 i LPPA-së. Vendimi i kundërshtuar me padi është marrë në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, lidhur me konstatimin e parë, e paditura parashtron

se sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, çdo ndërmarrje-respektivisht shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ka personalitet të ndarë juridik, prandaj në rast se një ndërmarrje është pronare dhe aksionare e ndërmarrjes tjetër nuk mund të thuhet se “kemi të bëjmë me të njëjtin subjekt afarist”, ndërsa lidhur me konstatimin e dytë paditësja parashtron se ndërmarrja pronare e saj N.N. “R&Rukolli” SH.P.K., ka përfituar dy herë nga dyqind mijë (200,000.00) euro, mbështetje financiare për projektet e saj nga ana e AZHB-së, MBPZHR, gjatë periudhës së lartcekur, në shumë të përgjithshme prej 400,000.00 euro, andaj e paditura ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike, ku në arsyetimin e vendimit kontestues ka theksuar se N.N. “R&Rukolli”, SH.P.K., ka tejkaluar ndihmën maksimale publike për periudhën e zbatimit të programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014/2020 për Masën 103, e që sipas ligjeve dhe akteve nënligjore është 800,000.00 euro, për përfitues. I ka propozuar gjykatës që të aprovoj në tërësi si të themeltë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit “Drena” SH.P.K., dhe të anuloj si të paligjshëm vendimin Nr.39/19 të datës 16.12.20109, i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Kundërshtimet e të paditurës

7. Përfaqësuesi sipas autorizimit i palës së paditur në pretendimet e dhëna në përgjigje në padi, ka deklaruar se, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në mbështetje të Ligjit me nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe UA nr. 16/2019, për projektet e zhvillimit rural për vitin 2019, ka konstatuar se aplikuesi tani paditës “Drena” SH.P.K., së bashku me N.N. R&Rukolli”, SH.P.K., si subjekt afarist i njëjtë kalon vlerën e përkrahjes publike përkatësisht në nën masën përpunimi i qumështit në vlerë prej 800,000.00 euro. Pas ankesës së parashtruar nga aplikuesi, Komisioni për shqyrtimin e ankesave e ka konsideruar si të pa bazuar për faktin se duke u bazuar në nenin 13 par.5 për periudhën e zbatimit të programit për bujqësi dhe zhvillim rural 2014/200 për nën masën 103 është 800,000.00 euro për përfituesin, gjë që e cila ka kaluar vlerën e përkrahjes publike prej 800,000.00 euro si dhe duke u bazuar në dy dokumente zyrtare të cilat gjendjen në shkresat e lëndës dhe të cilat janë në pajtim me legjislacionin në fuqi, është konstatua se kemi të bëjmë me të njëjtin subjekt afarist dhe pronar juridik është i njëjti pronar. I

ka propozuar gjykatës që të refuzohet si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi palës së paditur me nr. 39/19 i datës 16.12.2019.

Provat e administruara

8. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimet e kundërshtuara Nr.3919 të datës 16.12.2019 dhe Nr.AZHB 07/04/03/4238/2019 i datës 14.10.2019, Formulari për aplikim i vitit 2019 nga paditësi DRENA Sh.P.K. për masën 103-sektori për përpunimin e qumështit, Certifikata e regjistrimit të fermerit në emër të paditësit DRENA SHPK me NUI:1075124 me datë 18.04.2018, Certifikatë e regjistrimit të biznesit NUI:811014381 në emër të biznesit Drena ShPK, me datë 14.05.2015, Plani i biznesit nga aplikuesi Drena ShPK për masën 103, Opinioni ligjor nga departamenti ligjor i MBPZHR i dhënë në komunikimet përmes e-mailit lidhur me aplikimin e paditësit DRENA ShPK për masën 103, dhe përfitimit nga programi për ndihmë publike për BZHR për vitin 2014 deri në 2020.
9. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenit 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.
10. Nga Vendimi i kundërshtuar Nr.3919 i datës 16.12.2019, është refuzuar ankesa si e pa bazuar e Drena SH.P.K., është obliguar AZHB për zbatimin e këtij vendimi, me arsyetim se, duke u bazuar në UA Nr. 16/19 përkatësisht neni 13 par.5 shkalla e përkrahjes publike 5.7 ndihma maksimale publike për periudhën e zbatimit të programit për bujqësi dhe zhvillim rural 2014/2020 për masën 103 është 800,000.00 euro për përfitues. Sipas interpretimit ligjorë nga zyra ligjore e MBPZHR-së të datës 08.10.2019, lidhur me pronësinë e subjektit afarist “Drena” SH.P.K., përkatësisht “R&Rukolli” SH.P.K., duke u bazuar në dokumente zyrtare është konstatuar se kemi të bëjmë me të njëjtin subjekt afarist ku pronar juridik është i njëjti person. Gjatë kontrollës administrative dhe opinionit të marrë Drejtoria e AZHB-së për vlerën e autorizuar është konstatuar se aplikuesi tani paditës “Drena” SH.P.K., së bashku me

N.N. R&Rukolli”, SH.P.K., si subjekt afarist i njëjti ka kaluar vlerën e përkrahjes publike 800,000.00 euro.

11. Nga Vendimi Nr.AZHB 07/04/03/4238/2019 i datës 14.10.2019, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka refuzuar mbështetjen financiare për përkrahje të projekteve për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të vitit 2019 për nën masën 103.1 Përpunimi i qumështit, me arsyetim se aplikuesi nuk i plotëson kushtet siç përcakton neni 13, i UA Nr. 16/20109, për masat dhe kriteret e përkrahjes për Zhvillimin Rural për vitin 2019 të datës 21.05.2019, me arsyetim se, duke u bazuar në UA Nr. 16/19 përkatësisht neni 13 par.5 shkalla e përkrahjes publike 5.7 ndihma maksimale publike për periudhën e zbatimit të programit për bujqësi dhe zhvillim rural 2014/2020 për masën 103 është 800,000.00 euro për përfitues. Nga një interpretim ligjorë nga zyra ligjore e MBPZHR-së të datës 08.10.2019, lidhur me pronësinë e subjektit afarist “Drena” SH.P.K., përkatësisht “R&Rukolli” SH.P.K., ku duke u bazuar në dokumente zyrtare për të cilat është konstatuar se kemi të bëjmë me të njëjtin subjekt afarist edhe pronar juridik është i njëjti person. Gjatë kontrollës administrative dhe opinionit të marrë nga Drejtoria e AZHB-së për vlerën e autorizuar është konstatuar se aplikuesi tani paditës “Drena” SH.P.K., së bashku me N.N. R&Rukolli”, SH.P.K., si subjekt afarist i njëjti ka kaluar vlerën e përkrahjes publike 800,000.00 euro.
12. Nga Certifikata e regjistrimit të fermerit “DRENA” SHPK me NUI:1075124 është regjistruar me datë 18.04.2018 me nr. të biznesit 811014381.
13. Nga Certifikatë e regjistrimit të biznesit Drena ShPK, është regjistruar si biznes me datë 14.05.2015, NUI:811014381, lloji i biznesit Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, themelues i shoqërisë është N.N. “R&Rukolli” SH.P.K, me aktivitet kryesor të biznesit, prodhimin e produkteve të qumështit, me aktivitet sekondar: Tregtia me shumicë e produkteve të qumështit, vezëve, vajrave dhe yndyrave të gatimit. NF 601260102
14. “R & Rukolli” SH.P.K. është i regjistruar me datë 12/01/2005, si Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, NUI 810618366, NRB 70222353, NF 600179643, me aktivitet kryesor të biznesit, Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore, me aktivitet sekondar Punimet e kulmit (çatisë), ku Fabrika Për Prodhimin E Qumështit DRENA është e regjistruar si njësi e R & Rukolli SH.P.K, me seli në Skenderaj.

15. Nga Formulari për aplikim i vitit 2019 nga paditësi DRENA ShPK për masën 103-sektori për përpunimin e qumështit, aplikuesi tani paditësi “Drena” SH.P.K., ka aplikuar për financimin në mbështetjen financiare për përkrahje së projekteve për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të vitit 2019 për nën masën 103.1 Përpunimi i Qumështit, sipas planit të biznesit për përpunimi i qumështit, pajisje për ambalazhimin e jogurtit me fruta dhe perime dhe erëza mikser dhe dozator për fruta, tank për fermentim, dhoma frigoferike dhe pajisje për prodhim të energjisë së ripërtitshme dhe trajtim i mbetjeve.
16. Nga Opinioni ligjor nga departamenti ligjor i MBPZHR i dhënë në komunikimet përmes e-mailit, lidhur me aplikimin e paditësit DRENA ShPK për masën 103, dhe përfitimit nga programi për ndihmë publike për BZHR për vitin 2014 deri në 2020, lidhur me pronësinë, e subjektit afarist Drena SH.P.K Përkatësisht N.N'R&RUKOLLI SH.P.K. nga Skenderaj, kanë informuar se bazuar ne dokumentacionin e besueshëm te: Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë - Certifikata e Regjistrimit te Biznesit 71163725 dhe numrit Fiskal 601260102 dhe Informatës mbi biznesin te lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dt. 18.05.2015, me numër 4633 e ka te regjistruar aktivitetin sekondar Tregtia me shumice e produkteve e qumështit, vezëve, vajrave dhe yndyrave te gatimit, vërtetohet se kemi te bëjmë me te njëjtin person juridik “Drena” SH.P.K te subjektit afarist N.N "R&Rukolli" SH.P.K nga Skenderaj. Nga Vendimi për aprovim te qumështores nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me Ref. AUV-01-33/15, te di. 27.01.2015 konstatohet se objekti për grumbullimin e qumështit, përpunimin dhe paketimin e produkteve, nga qumështi "DRENA" si subjekt afarist N.N “R&Rukolli” i ka plotësuar kushtet minimale higjiene-teknike te përcaktuar me ligj dhe për këta i lëshohet, numri i kontrollit RKS -040. Duke u bazuar ne dy dokumentacione të besueshme që janë zyrtare dhe ne pajim me legjislacionin në fuqi, kanë konstatuar se kemi te bëjmë me te njëjtin subjekt afarist dhe pronar juridik është i njëjti person ka te drejtën e aplikimit për Masë 103 ta Qumështit: sipas Neni: 4 paragraf 1 nen paragrafi 1.2 Masa 105; Investimet dhe asetet Fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore për vitin 2018 dhe nenin 13.1 I Udhëzimit Administrativ (MBPZHR)-NR 05/2018 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillimin Rural, për vitin 2018 te dt. 08.03.2018 citohet: 1.1. Përfitues mund te jene ndërmarrjet e përpunimit te qumështit, të mishit, te pemëve dhe të perimeve, si dhe prodhuesit e verës, te

regjistruara ne Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve te Kosovës, së paku dy vite ne nen sektorin përkatës; prandaj subjekti i regjistruar ne ARBK "DRENA" si subjekti afarist N.N "R&Rukolli", pasi është i regjistruar së paku dy vite ne sektorin përkatës te qumështit dhe Vendimin për aprovim te qumështores nga AUV me Ref.:AUV-01-33/15 te dt. 27.01.2015 për grumbullimin e qumështit, përpunimin dhe paketimin e produkteve nga qumështi i plotëson kriterin për përfitues përfundimtar, natyrisht nëse i plotëson edhe kriteret tjera.

Baza Ligjore

17. UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.16/2019 PËR MASAT DHE KRITERET E PËRKRAHJES PËR ZHVILLIM RURAL PËR VITIN 2019, neni 13 paragrafi 1 përcakton, se *“Përfitues mund te jene ndërmarrjet e përpunimit te qumështit, te mishit, te pemëve dhe te perimeve, si dhe prodhuesit e verës, te regjistruara ne Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve te Kosovës, se paku dy vite ne nën sektorin përkatës”*, paragrafi 5 parasheh shkallën e përkrahjes publike, nën paragrafi 5.7 parasheh se *“Ndihma maksimale publike për periudhën e zbatimit te programit për bujqësi dhe zhvillim rural 2014-2020 për Masën 103 është tetëqind mije euro (800.000.00)€ për përfitues;*
18. Ligji Nr. 03/L-098 PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL Neni 8 përcakton se *“Përfituesit nga masat mbështetëse Përfituesit nga fondi i programit nëpërmjet masave, të cilat ndërmerren në kuadrin e politikës së bujqësisë dhe të zhvillimit rural janë fermerët, grupet e fermerëve, personat fizik apo juridik të cilët zhvillojnë aktivitete në sferën e bujqësisë dhe zhvillimit rural“*. Neni 9 parasheh Aplikimet, ndërsa paragrafi 1 përcakton se *“Aplikimet për të përfituar fonde nga masat mbështetëse për politikat bujqësore dhe të zhvillimit rural mund të paraqiten nga një fermer, grup fermerësh, personat fizik apo juridik siç parashikohet me këtë ligj”*.
19. LIGJI Nr. 06/L -016 PËR SHOQËRITË TREGTARE Neni 75 përcakton Natyrën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe e Aksionit 1. *Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është person juridik e cila është juridikisht e ndarë nga aksionarët. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është vetvetiu bartëse e te drejtave dhe obligimeve. Neni 76 përcakton Parimin e Përgjegjësisë 1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është përgjegjëse për të gjitha borxhet e saj dhe detyrimet tjera metë gjitha asetet e saj dhe*

2. Një aksionar i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar nuk është përgjegjës për borxhet ose detyrimet e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar vetëm për arsye se është aksionar.

20. LIGJI Nr. 06/L- 032 PËR KONTABILITET, RAPORTIM FINANCIAR DHE AUDITIM, Neni 15 Konsolidimi i pasqyrave vjetore financiare ...paragrafi . 2. *Kompania mëmë, sipas kuptimit të këtij Ligji, konsiderohet ndërmarrësi i cili përmbush të paktën një (1) nga këto kushte: 2.1. ka shumicën e pronësisë së aksioneve ose të pjesës (aksioneve), që i jep të drejtën e votimit për ndërmarrësit tjerë; 2.2. ka të drejtë të propozojë ose shkarkojë shumicën e anëtarëve të menaxhmentit (Drejtori) ose bordit mbikëqyrës të ndërmarrësit tjetër; 2.3. ka të drejtën e ndikimit të rëndësishëm drejt ndërmarrësit tjetër sipas kontratës ose ndonjë marrëdhënie tjetër juridike. 2.4. nëse shumica e anëtarëve të menaxhmentit ose bordit mbikëqyrës të ndërmarrësit vartës, të cilët kanë ushtruar këtë funksion në vitin e fundit afarist dhe vazhdojnë ta ushtrjnë, deri në hartimin e raportit vjetor financiar, janë caktuar vetëm për të ekzekutuar të drejtën e votimit të kompanisë mëmë; ose 2.5. kanë aksione ose të drejtën e vendim-marrjes në kompaninë vartëse për të mbikëqyrë të drejtën e votës në kompaninë vartëse.*

Vlerësimi i gjykatës

21. Pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, deklarimeve në padi nga paditësi, kundërshtimeve sipas përgjigjes në padi nga e paditura, si dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

22. Prandaj, Gjykata vlerëson se nga provat e administruara konstatohet Drena ShPK, është themeluar si Filiale/Njësi e varur e Shoqërisë mëmë N.N. “R&Rukolli” SH.P.K si i vetmi aksionar i kompanisë Drena SH.P.K. Sipas LIGJI Nr. 06/L -016 Për Shoqëritë Tregtare Neni 75, paragrafi i 1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është person juridik e cila është juridikisht e ndarë nga aksionarët. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është vetvetiu bartëse e te drejtave dhe obligimeve. Sipas Neni 76 paragrafi 1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është përgjegjëse për të gjitha borxhet e saj dhe detyrimet tjera metë gjitha asetet e saj, dhe 2. Një aksionar i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar nuk është përgjegjës për borxhet ose detyrimet e Shoqërisë me Përgjegjësi

të Kufizuar vetëm për arsye se është aksionar. Pra përfitimi kryesor i shoqërive të varura është se ato janë persona juridikë të ndryshëm nga kompania e tyre mëmë. Kjo do të thotë që të dy kompanitë mund të kufizojnë detyrimet ose detyrimet e përbashkëta dhe do të jenë të ndara për sa i përket rregulloreve ose taksave.

23. E Paditura në Vendimin e kundërshtuar Nr.3919 i datës 16.12.2019, ka interpretuar gabimisht Natyrën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe e Aksionarit duke konstatuar se kemi të bëjmë me të njëjtin subjekt afarist ku pronar juridik është i njëjti person, në kundërshtim me neni 75 dhe 76 të LSHT.
24. Mirëpo e paditura, ka interpretuar gabimisht edhe Udhëzim Administrativ Nr.16/2019 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për Vitin 2019, neni 13 paragrafi 5 ku përcaktohet shkalla e përkrahjes publike, nën paragrafi 5.7 parasheh se “*Ndihma maksimale publike për periudhën e zbatimit të programit për bujqësi dhe zhvillim rural 2014-2020 për Masën 103 është tetëqind mijë euro (800.000.00)€ për përfitues*; në atë mënyrë duke e konsideruar përfitues subjektin afarist aplikues pa dhënë sqarime lidhur me mënyrën e aplikimit, respektivisht nëse aplikuesi N.N. R&Rukolli” SH.P.K ka aplikuar si aplikues kryesor duke vepruar individualisht apo si bashkë aplikues me tani paditësin “Drena” SH.P.K., të cilët së bashku duhet të përmushin kriteret për përfitimi të grantit.
25. Verifikimi i mënyrës së aplikimit është më se i domosdoshëm për arsye të definimit të **statusit të përfituesit** duke pasur parasysh aktivitetin kryesor për të cilën është regjistruar “R & Rukolli” SH.P.K, NUI 810618366, NRB 70222353, NF 600179643, ku aktivitet kryesor të biznesit ka ndërtimin e objekteve banesore dhe jo banesore, ndërsa aktivitet sekondar ka punimet e kulmit (çatisë). Ndërsa, sipas Ligji Nr. 03/L-098 PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL Neni 8 përcaktohet se “*Përfituesit nga masat mbështetëse Përfituesit nga fondi i programit nëpërmjet masave, të cilat ndërmerren në kuadrin e politikës së bujqësisë dhe të zhvillimit rural janë fermerët, grupet e fermerëve, personat fizik apo juridik të cilët zhvillojnë aktivitete në sferën e bujqësisë dhe zhvillimit rural* “. Neni 9 parasheh Aplikimet, ndërsa paragrafi 1 përcakton se “*Aplikimet për të përfituar fonde nga masat mbështetëse për politikën bujqësore dhe të zhvillimit rural mund të paraqiten nga një fermer, grup fermerësh, personat fizik apo juridik siç parashikohet me këtë ligj*”.

Prandaj, pasi që e paditura në përgjigje në padi nuk e ka dorëzuar asnjë formular të aplikimit nga “R & Rukolli” SH.P.K, dhe vendim me të cilin i është njohur e drejta në përfitim të grantit, çka do ti mundësonte gjykatës që të vlerësojë vet gjendjen faktike dhe të vendos çështjen e padisë në mënyrë meritore, e paditura në procedure të rivendosjes të sqaroj se si ka aplikuar dhe si është kualifikuar “R & Rukolli” SH.P.K, për Masë 103 të prodhimit të qumështit: sipas Neni: 4 paragraf 1 nën paragrafit 1.2 Masa 105; Investimet dhe asetet Fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore për vitin 2018 dhe nenin 13.1 I Udhëzimit Administrativ (MBPZHR)-NR 05/2018 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillimin Rural, për vitin 2018 të dt. 08.03.2018, sepse përpunimi i qumështit nuk bie në aktivitetin e tij të rregullt të biznesit. Përkatësisht të sqaron nëse “R & Rukolli” SH.P.K, ka aplikuar për përfituesin “Drena” Sh.P.K, në cilësi të kompanisë themeluese (kompanisë mëmë) si subjekt juridik, që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë e kontrollon Paditësin “Drena ShPK, me aktivitet kryesor të biznesit, prodhimin e produkteve të qumështit, me aktivitet sekondar: Tregtia me shumicë e produkteve të qumështit, vezëve, vajrave dhe yndyrave të gatimit, me aksionar të vetëm N.N. “R&Rukolli” SH.P.K, sepse vetëm në këtë mënyrë N.N. “R&Rukolli” SH.P.K, do të mund të kualifikohej për përfitim të grantit në fushën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

26. Pra në këtë rast pavarësisht se subjektet nuk janë të njëjta, të sqarohet përfituesi sepse duke pas parasysh fushë veprimtarin e “R&Rukolli” SH.P.K, dhe “Drena” ShPK, rezulton se përfitues mund të jetë vetëm njësi themeluese “Drena” ShPK, por që aplikues mund të jetë “R & Rukolli” SH.P.K në cilësi të kompanisë themeluese (kompanisë mëmë) si subjekt juridik, që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë e kontrollon përfituesin në këtë rast paditësin.

27. Po ashtu në komunikimet zyrtare përmes e-mailit, theksohet se Drena Sh.P.K. ka qenë përfituese e grantit për dy vite, ndërsa nuk sqarohet shuma e përfitimit. Prandaj, në procedurë të rishqyrtimit obligohet e paditura, që në mënyrë të plotë të vërtetojë gjendjen faktike dhe në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe t'i mënjanojë të metat e vendimit kontestues, në atë mënyrë ta sqaroj se në çfarë cilësie “R & Rukolli” SH.P.K ishte kualifikuar si përfitues i grantit për përpunimin të qumështit,

të mishit, të pemëve dhe të perimeve, si dhe prodhuesit e verës, të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, sepse duke pasur parasysh se aktivitet kryesor të biznesit ka Ndërtimin e objekteve banesore dhe jo banesore, ndërsa aktivitet sekondar ka Punimet e kulmit (çatisë) i njëjti nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, ashtu që të konstatoj se kush është përfitues i grantit sipas mënyrës së aplikimit në kuptim të Udhëzimit Administrativ Nr.16/2019 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për Vitin 2019, ku *Ndihma maksimale publike për periudhën e zbatimit të programit për bujqësi dhe zhvillim rural 2014-2020 për Masën 103 është tetëqind mijë euro (800.000.00)€ përkufizohet për përfitues*, pavarësisht se kemi të bëjmë me dy persona juridikë të ndryshëm në kuptim të nenit 75 dhe 76 të LSHT.

28. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Vendimi për shpenzimet procedurale u more në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.340/22, datë 22.04.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.